

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
REKTOR

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BNJ DHE INFORMACIONIT, P-A

URDHËR

Nr. 44, datë 07.11.2019

MBI

“PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Në zbatim të nenit 112 të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të neneve 1 dhe 5 të ligjit nr.10289, datë 17.06.2010 për “Mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”; të nenit 2, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 për “Statusin e invalidëve të punës” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869, datë 18.06.2008 për “Zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 për “Statusin e invalidëve të punës” (i ndryshuar); nenit 6 të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 për “Statusin e jetimit” (i ndryshuar); nenit 8 të ligjit nr. 8098 datë 28.03.1996 për “Statusin e të verbrit”(i ndryshuar); nenit 8 të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 për “Statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar); nenit 12 të ligjit nr. 7748, datë 29.07.1993 për “Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” (i ndryshuar); nenit 32 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 për “Ndihmën dhe shërbimet shoqërore”(i ndryshuar), të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016 për “Përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studenët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” (i ndryshuar), të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 39, datë 23.01.2019 për “ disa ndryshime në vkm nr. 903/21.12.2016”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e aplikimeve të studentëve, që do të përfitojnë bursë, për vitin akademik 2019 - 2020, me përbërje si më poshtë:

Personat përgjegjës që do të merren me administrimin e procesit në çdo Fakultet, janë si më poshtë:

- Nermin Zebi (Fakulteti i Muzikës)
- Arta Dashi (Fakulteti i Arteve të Bukura)
- Enela Mastori (Fakulteti i Artit Skenik)

2. Grupi i punës ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016 për “Përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
REKTOR

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BNJ DHE INFORMACIONIT, P-A
për studenët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programë studimi në fushat
prioritare dhe studentët në nevojë” (i ndryshuar).

3. Grupi i punës pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga studentët, mban proces-verbal ku përcakton studentët që përfitojnë ose jo, bursë për vitin akademik 2019-2020 dhe i përgatit informacionin Administratores së Universitetit të Arteve (UART) për miratim në Bordim e Administrimit.
4. Afati përfundimtar për mbarimin e punës nga ana e grupit të punës është data 26.11.2019.
Përrjashtimisht për vitin akademik 2019-2020, përfitojnë bursa financiare, studentët e regjistruar në vitin e parë dhe në vitet pas të parit, në ciklin e parë të studimeve në UART në programet e mësimit në fushën e mësuesisë, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.04.2018. Studentët e regjistruar në vitin e parë në UART, sipas përcaktimeve të mësipërme, duhet të përmbushin kriterin e notës mesatare 9 deri në 10, e përllogaritur si mesatare e notave të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore. Studentët e regjistruar pas të parit, sipas përcaktimeve të mësipërme, duhet të përmbushin kriterin e notës mesatare 9 deri në 10, e përllogaritur si mesatare e notave të gjitha detyrimeve të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe të shlyera për vitet pararendëse.
5. Studentët e viteve të dyta dhe të treta të ciklit të parë Bachelor në fakultet pranë UART të paraqesin dokumentacionin e kërkuar si më poshtë në Personat përgjegjës pranë grupit të punës, deri në datën 21.11.2019.
6. Studentë në nevojë konsiderohen:
 - a) Sipas kriterit ekonomik:
 - Studentët që ndjekin studimet në largësinë mbi 10 (dhjetë) km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike nga njësia e vetëqeverisjes vendore;
 - Secili nga studentët, i cili rezulton bashkëshort me fëmijë, dhe kur familja e tij trajtohet me ndihmë ekonomike nga njësia e vetëqeverisjes vendore;
 - Personat me aftësi të kufizuar, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punës, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.
 - b) Jashtë kriterit ekonomik:
 - Studentët që kanë përfitur statusin e jetimit;
 - Studentët që kanë humbur përgjegjësinë prindërore, me vendim gjykatë të formës së prerë;
 - Studentët që janë identifikuar e trajtuar si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;
 - Studentët që rezultojnë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BNJ DHE INFORMACIONIT, P-A

Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

7. Studentët nuk përfitojnë bursë apo humbasin të drejtën e përfitimit, sipas shkronjave të sipërcituara, në rast se:
- janë ndarë nga trangu familjar;
 - familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;
 - vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;
 - shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese;
 - nuk kanë përfunduar programin e studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij, të përcaktuar në aktin e hapjes së programit përkatës të studimit.
8. Studentët në nevojë, sipas dhe jashtë kriterit ekonomik, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:
- Vërtetim nga fakulteti që është student;
 - Fotokopje e kartës së ID;
 - Çertifikatë familjare e tre muajve të fundit (trangu familjar);
 - Vërtetim nga Njësia e qeverisjes vendore, për ndihmën ekonomike, me emrin e K/familjarit;
 - Vërtetim nga ISSH (për të gjithë pjestarët e familjes për të vërtetuar nëse përfitojnë ndonjë lloj pensioni).
 - Vërtetim të pagës mujore për secilin anëtar të familjes në marrëdhënie pune, nga qendrat e tyre të punës;
 - Vërtetim nga Zyrat Vendore e Punësimit, nëse figuron si i papunë për çdo anëtar të familjes;
 - Vërtetim nga zyra e përkrahjes sociale pranë njësive të qeverisjes vendore, për çdo person sipas certifikatës familjare, që ka mbushur 18 vjeç. Vërtetimi të ketë numrin e kartelës;
 - Në rast se prindrit janë në pension, vërtetim nga Dega e Sigurimeve Shoqërore të rrethit, për pagesën e pensionit, kompensimet, etj., Vërtetimi të ketë numrin e kartelës së pensionit;
 - Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, që vërteton se anëtarët e familjes së studentit nuk ushtrojnë aktivitet privat;
 - Për motrat dhe vëllezërit që janë në shkollë, vërtetim nga shkolla nëse gëzojnë bursë ose jo;
 - Vërtetim nga ZVRPP (zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të palujtëshme), për të gjithë anëtarët e familjes, sipas certifikatës, që me pronat e palujtëshme nuk krijojnë të ardhura;
 - Vërtetim nga zyra e Kadastrës për tokën;
 - Vërtetim nga Institucionet Shtetërore, për anëtar e familjes, që janë ushtar, jashtë shtetit;
 - Deklaratë nga K/familjari, për dokumentacionin e studentit;
 - Secili nga studentët bashkëshortë me fëmijë që plotësojnë kriterin ekonomik;


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
REKTOR

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BNJ DHE INFORMACIONIT, P-A

- Studentët, me aftësi të kufizuar (Vendim nga KMCAP, Dëshmi zyrtare identifikimi, Raporti mjeksor i lëshuar nga KMCAP/ Vërtetim nga DSSH dhe gjithë dokumentacionin e përmendur;
 - Dokumenti nga Instucionet Shtetërore, per Statusin Jetim.
9. Studentët me rezultate të arritura në studime, përfitojnë bursë sipas pikave të mëposhtme:
- a) Studentët e shkëlqyer që ndjekin programet e studimeve me kohë të plotë të ciklit të parë, në vitin e parë të vitit akademik 2019-2020 dhe që janë shpallur nga MAS më të mirët e Maturës Shtetërore. Kjo listë hartohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe i dërgohet Institucioneve të Arsimit të Lartë (UART).
 - b) Për studentët e regjistruar në vitet pas të parit, notë mesatare maksimale do të konsiderohet nota 10 (dhjetë), e përlllogaritur si mesatare e notave të të gjitha provimeve/detyrimeve të shlyera dhe të parashikuara për programin përkatës të studimit për vitet pararendëse. Këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës.
10. Studentët me rezultate të arritura në studime, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:
- Fotokopje e kartës së ID;
 - Lista e notave, e firmosur nga K/sekretarët dhe Dekani i Fakultetit dhe e vulosur;
 - Vërtetimin e studentit në vitin akademik 2019-2020;
 - Numri i llogarisë bankare (pranë bankës CREDINS).
11. Studentët që ndjekin studimet në UART në vitet e tjera, pas vitit të parë të studimeve, që nuk kanë përfituar bursë në vitin e parë akademik dhe plotësojnë kriteret e parashikuara të këtij urdhëri, mund të përfitojnë bursë brenda numrit të bursave të planifikuara dhe që administrohen nga institucionet publike të arsimit të lartë.
12. Studentët e vitit të parë, sipas pikës 6 të këtij urdhri, i drejtohen Këshillit të Bashkisë për përfitim burse.
13. Në çdo rast, kur një aplikues student paraqet dokumentacion, për përfitimin e bursës për vitin akademik 2019 - 2020, që në të ardhmen rezultojnë jo ligjorë, përgjegjësia bje mbi studentin i cili do të penalizohet.
14. Personat përgjegjës i regjistrojnë aplikimet e studentëve në një regjistër të veçantë dhe pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga studentët, i përgatit informacionin Administratores së Universitetit të Arteve (UART), për miratim në Bordin e Administrimit dhe e dorëzon të gjithë dokumentacionin pranë Zyrës së Protokollit në Rektorat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
REKTOR

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BNJ DHE INFORMACIONIT, P-A

15. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Web-it, të Universitetit të Arteve.
16. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, grupi i punës, zyra e protokollit, Dekanët dhe K/Sekretarët e Fakulteteve pranë Universitetit të Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

Prof. Kastriot Çaushi

REKTOR

UNIVERSITETI I ARTEVE

